



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:271957

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05731314

K.DH.SH.II.nr.1456/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Bajraktari” ShPK, me numër të biznesit 810695306 me seli në Vushtri, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Palushi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.106/22 të datës 18.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.106/22 të datës 18.08.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar KA.nr.106/22 të datës 18.08.2023, Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, nën pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit, është aprovuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Bajraktari” ShPK me numër të biznesit

810695306 me seli në Vushtrri. Nën pikën II. të dispozitivit, Anulohet vendimi i Panelit Shqyrtues të Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me seli në Prishtinë, me shifër PSH.nr.112/19 dhe 122/19 të datës 20.05.2019 dhe çështja i kthehet OSHP-së në rishqyrtim dhe rivendosje. Nën pikën III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë e paditura Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë, për shkak të: konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurit Organit Shqyrtues i Prokurimit, se e bazuar ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.106/22 të datës 18.08.2023të anulohet si i pa bazuar dhe njëherit të mbetet në fuqi vendimi i panelit shqyrtues të OSHP –së PSH.nr. 112/19 122/19 i datës 12.04.2019.

Paditësi ka paraqitur përgjigje në ankesë duke konsideruar se pretendimet e të paditurës se aktgjykimi i atakuar ka bërë vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale nuk qëndrojnë. Andaj duke u bazuar në faktet e rastit, paditësi me respekt ka kërkuar nga Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, Departamenti për Çështje Administrative që të refuzoj si të pa themeltë ankesën e Organit Shqyrtues të Prokurimit kundër aktgjykimit të KA.nr.106/22 dhe të vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, me nr. KAnr.106/22 i datës 18.08.2023.

Dhoma e Shkallës së Dytë shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar të Organit Shqyrtues të Prokurimit, PSH.nr. 112/19 122/19 i datës 12.04.2019, nën pikën I të dispozitivit të vendimit, është aprovuar pjesërisht si e bazuara ankesat e operatorëve ekonomik “Bajraktari”-Vushtrri dhe “Lirigzoni S” ShPK-Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i shtratit të lumit Ibër në Mitrovicë, bashkëfinancim me MMPH” me numër të prokurimit: 642-18-024-5-

1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna e Mitrovicës. Nën pikën II të dispozitivit Vërtetohet, Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rregullimi i shtratit të lumit Ibër në Mitrovicë, bashkëfinancim me MMPH” me numër të prokurimit: 642-18-024-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna e Mitrovicës . Nën pikën III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet të informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Nën pikën IV të dispozitivit, mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/L-237, të Ligjit 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues. Nën pikën V. Meqenëse ankesa e operatorit ekonomik ankesë “Bajraktari”-Vushtrri dhe Lirigzoni-S Shpk Prishtinë, aprovohen si pjesërisht e bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Në pikën VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 19.06.2019, me pretendim se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të paditurës dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar duke e anuluar vendimin e të paditurës OSHP dhe çështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje. Me arsyetim se gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar përmban kontradikta me vetvetën, në atë mënyrë që përderisa konstaton se OE “Bajraktari” vlerësohet si ofertues i përshtatshëm që i ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në dosjete tenderit e në anën tjetër konstatohen shkeljet të vazhdueshme e të përsëritura nga AK në raport me kërkesat e aplikuar jashtë kërkesave specifike në dosjete tenderit dhe njoftimin për kontratë në kundërshtim me nenin 56 paragrafi 3 dhe nenin 59 të LPP-së Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, dhe njëkohësisht i jep të drejtë AK për kërkesat ndaj OE “Bajraktari” lidhur me sqarimet dhe referencat e ofruara, respektivisht prerjen për secilin vit fiskal veç e veç dhe për situacionet e realizuara së bashku me dëshmitë e pagesave,

për të vlerësuar nëse i plotëson kërkesat në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë dhe konsideron se ka vepruar në pajtim me nenin 59 paragrafi 3 të LPP-së. Gjykata vlerëson se autoriteti kontraktues në procedurën e ekzaminimit vlerësimit dhe krahasimit të ofertave përkundër vendimeve paraprake ku janë evidentuar shkeljet e konstatuara nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së nuk i ka eliminuar shkeljet sipas vërejtjeve të panelit shqyrtues as në vendimin e kundërshtuar por ka vazhduar me kërkesa që nuk kanë të specifikuar e të cilat i ka aplikuar në procedurën e përzgjedhjes, respektivisht eliminimin të vetëm njërit nga operatorët ekonomik që kanë ofertuar. Përfundimisht gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar PSH.nr. 112/19 122/19 i datës 12.04.2019 përkundër që ri konfirmon shkeljet e konstatuara, njëkohësisht vlerëson se AK në kërkesat nga OE “Bajraktari” lidhur me sqarimet për referenca e ofruara, respektivisht prerjen për secilin vit fiskal veç e veç dhe për situacionet e realizuara së bashku me dëshmitë dhe konsideron se ka vepruar në pajtim me nenin 59 paragrafi 3 të LPP-së nuk jep asnjë vlerësim lidhur me relevancën e kërkesës së AK për informata shtesë nga OE “Bajraktari” respektivisht relevancën e kërkesës që të bëhet prerja për secilin vit fiskal veç e veç dhe të nxjerrën vlerat për situacionet e realizuara së bashku me dëshmitë e pagesave në raport me dëshmitë e dorëzuara, dhe vetëm konstaton në mënyrë të përgjithësuar se sqarime shtesë megjithatë të dhëna nga OE “Bajraktari” nuk e kanë bindur AK pa dhënë asnjë vlerësim se çfarë sqarime kishte ofruar OE “Bajraktari” edhe pse nuk ishin të mjaftueshme për ta bindur autoritetin kontraktues. Prandaj sipas Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 48 par.2 konsiderohet arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i pa qartë kundërthënës apo i pakuptueshëm...”. Në procedurë të ri vlerësimit të evitohen shkeljet e konstatuara në paragrafin 25. Andaj bazuar në nenin 12 par.1 nën par 1.12 lidhur me par 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar provat dhe pretendimet e paditësit lidhur me kërkesëpadinë e tij, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Përkundër se aktgjykimi i Dhomës së Shkallës së Parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, kolegji i kësaj gjykate të njëjtin e ka shikuar sipas detyrës zyrtare sa i përket kësaj baze ankimore, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit Dhoma e Shkallës së Parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës në ankesë se nuk është i qëndrueshëm vlerësimi i shkallës së parë se paditësi ka ofertuar sipas nenit 69 të LPP-së sepse nëse vetëm një nga kriteret e AK-së të specifikuar në dosjen e tenderit nuk përmbushet, atëherë i bie që ofertuesi nuk është i përgjegjshëm, andaj në mungesë të ofertave të përgjegjshme, aktiviteti i prokurimit anulohet konform nenit 62 të LPP-së, sikurse në rastin konkret. E paditura thekson se e paditura nuk e ka kthyer çështjen në rivlerësim por e ka vërtetuar vendimin e AK-së për anulim andaj kemi të bëjmë vetëm me vendimin e atakuar nga paditësi dhe për secilin vendim që është marr nga i paditur OSHP. Andaj nuk qëndron arsyetimi i gjykatës se në procedurë të rivlerësimit të evitohen shkeljet e konstatuara në paragrafin 25. Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, meqë Dhoma e Shkallës së Parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se e paditura nuk ka arsyetuar fare pretendimet e paditësit por vetëm ka përshkruar kronologjinë e ngjarjes, po ashtu Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë i është referuar nenit 59 paragrafi 3 të LPP-së, andaj e anuloi vendimin e Panelit Shqyrtues të Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me seli në Prishtinë, me shifër PSH.nr.112/19 dhe 122/19 të datës 20.05.2019 dhe çështjen e kthen tek i padituri OSHP-së në rishqyrtim dhe rivendosje. Kolegji konstatoj se nuk është provuar ndryshe nga e paditura në asnjë fazë të procedurës të këtij konflikti administrativ. Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes. Prandaj, në një gjendje të tillë të vlerësimit, sipas bindjes edhe të kolegjit të kësaj gjykate e bënë të pa qëndrueshëm arsyetimin e vendimit kontestues. Ngase në arsyetim të vendimit të kontestuar është dashur të vlerësohen pretendimet e paditësit që kanë rëndësi vendimtare në mënyrë që të jepen sqarime bindëse.

Kurse, sa i përket pretendimeve tjera ankimore se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka vlerësuar provat e administruara, dhe po ashtu gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës. Kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se janë të pa bazuara dhe

të pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë, pasi që i padituri nuk ka provuar me asnjë provë të vetme pretendimin për eliminimin e paditësit për shkak të mos plotësimit të kushteve, ku në këtë rast paditësi ka paraqitur dëshmitë siç janë projektet e përfunduara të ngjashme ndërtimore në tri vitet e fundit në vlerë monetare 4,000,000.00€ (katër milion euro) e cila dëshmi parashihej të paraqitet me rastin e aplikimit për aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i shtratit të lumit Ibër në Mitrovicë, bashkëfinancim me MMPH” ndërsa në dosjen e tenderit ishte kërkuar që vlera e këtyre punëve të jetë rreth 2.8 milion Euro. Andaj, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se vendimi i kontestuar i të paditurës përmban të meta të tilla esenciale të lartcekura që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së tij ndërsa, aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon Dhoma e Shkallës së Dytë.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore se Dhoma e Shkallës së Parë ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, gabimisht vlerësoi provat e administruara po ashtu gabimisht aplikoi edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, Ky kolegji këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara me prova konkrete, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon Dhoma e Shkallës së Dytë. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditurit.

Përfundimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim në Dhomat e Shkallës së Parë apo të vendoset ndryshe.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2019:271957
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05731314

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.1456/23, me datë 24.05.2024

**Kryetare i kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**